



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

P r e z e n c a n ë S h q i p ë r i

Fjala e Kryetarit të Prezencës, Ambasadorit Robert Bosch, në seancën plenare të Konsorciumit Ndërkombëtar Hotel “Tirana International”, 15 prill 2010

Të nderuar Ministër Nishani, Zëvendësministër Peka, Prokurore e Përgjithshme Rama, Ambasadori Lohan, Zëvendësshef i misionit Jones, të nderuar të ftuar, zonja dhe zotërinj, mirëmëngjesi!

Jam shumë i kënaqur t’ju drejtohem sot në Seancën Plenare Vjetore të Konsorciumit Ndërkombëtar.

Do të doja të përgëzoja të gjithë ata individë nga agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare të cilët përbëjnë Konsorciumin Ndërkombëtar, për një vit tjetër të suksesshëm pune të madhe dhe arritjesh.

Do të doja të shprehja në mënyrë të veçantë vlerësimin tim për Komitetin Drejtues dhe asistenten programore të ICITAP-it, znj. Liljana Kristo, për përkushtimin që kanë treguar në punën e tyre për funksionimin e mirë të këtij mekanizmi të vlefshëm bashkërendimi.

Të nderuar kolegë, më lejoni të përmend shkurtimisht disa nga pikat kryesore të vitit të shkuar.

Për sa i përket policisë së shtetit, një nga arritjet më mbresëlënëse ka qenë puna e saj gjatë periudhës së zgjedhjeve parlamentare.

Policia, pa dyshim, e ka kryer punën e saj në mënyrë shumë profesionale dhe të paanshme dhe për këtë është lëvduar në disa raporte të ndërkombëtarëve për zgjedhjet.

Kjo është shenjë e qartë se reforma në polici po ecën në drejtimin e duhur.

Me strukturën aktuale, është krijuar tashmë pa dyshim baza për një shërbim policor bashkëkohor, i gatshëm për sfidat e shekullit të njëzetënjtë.

Krijimi dhe zbatimi i një mënyre më efçente dhe më efektive policimi, mbetet një sfidë e madhe për të ardhmen.

Për arritjen e këtij objektivit, nevojitet krijimi i një kuadri buxhetor më të qëndrueshëm.

Gjithashtu, policia duhet të ketë në dispozicion edhe mjetet e duhura për të kryer punën e saj.

Pa këtë, ne nuk do mund të shohim një polici efçente dhe profesionale dhe nuk do të mund të shohim fitoren në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Jam i kënaqur që vërej se policia ka filluar zbatimin e filozofisë së policisë së komunitetit në drejtoritë rajonale.

Këto hapa të parë drejt përmirësimit të marrëdhënieve me publikun do të japin rezultatet e tyre në të ardhmen dhe Prezenca e OSBE-së është e gatshme të ofrojë ndihmën e saj sa herë të kërkohet një gjë e tillë.

Sigurisht që policia nuk është i vetmi organ i zbatimit të ligjit – gjykatat dhe prokuroritë kanë gjithashtu një rol të rëndësishëm në këtë proces.

Këto institucione duhet të drejtohen nga persona që respektojnë sundimin e ligjit në vend.

Gjithsesi, siç e kam përmendur, të gjitha përpjekjet e autoriteteve shqiptare duhet të përqendrohen në forcimin e luftës për reduktimin dhe çrënjosjen e këtyre dy fenomeneve negativë.

Për këtë do të përgëzoja politikën e qeverisë për zero tolerancë kundër korrupsionit - një politikë së cilës i është kushtuar vëmendje nga shumë organizata ndërkombëtare dhe kryeqytete.

Siç e dimë, është një politikë që ka korrur shumë suksese që nga viti 2005.

Megjithatë, do të inkurajoja të gjithë institucionet kombëtare dhe aktorët që kanë detyrën të drejtojnë këtë luftë, që të përqendrojnë më tej vëmendjen e tyre te çdo person të përfshirë në korrupsion, në postet politike dhe publike, – pavarësisht rangut apo ngjyrimin politik.

Për më tepër, gjatë vitit të kaluar, shumë prej reformave të nevojshme në këtë sektor kanë ngecur.

Mungesa e opozitës në parlament pas zgjedhjeve të përgjithshme, ka shkaktuar vonesa në miratimin e ligjeve për të cilat kërkohet një shumicë votash prej tre të pestave.

Pjesa më e madhe e legjislacionit penal kërkon një shumicë të tillë votash, ashtu si edhe ligji i shumëpritur i gjykatave administrative.

Mungesa e opozitës do të thotë gjithashtu që shumica e ligjeve po miratohen pa pasur nivelin e pritshëm të diskutimeve.

Po shfrytëzoj rastin për t'i kërkuar opozitës që të reflektojë gjatë dhe thellë për veprimet e veta, të cilat tashmë *de facto* po dëmtojnë procesin drejt një sistemi demokratik modern.

Duhet bërë e mundur që ata të ndjejnë se pjesëmarrja e tyre aktive dhe e vazhdueshme në Kuvendin e Shqipërisë është e mirëpritur si me fjalë ashtu dhe vepra.

Do të doja që, po në këtë kuadër, t'i kërkoja Qeverisë të bëjë përpjekje të mëtejshme për të siguruar që të gjitha ligjet të diskutohen nga të gjithë grupet e interesit para se të miratohen në parlament.

Megjithatë, është parë progres në lidhje me disa nga politikat.

Duhet të pranojmë dhe përgëzojmë faktin që Shqipëria ka miratuar tashmë ligjin historik dhe domethënës kundër-diskriminimit.

Ky ligj mbron një rreth të gjerë qytetarësh nga praktikat diskriminuese.

Edhe pse media ka përqendruar vëmendjen kryesisht te mbrojtja e komunitetit të LGBT, i cili është një zhvillim pozitiv, nuk duhet të harrojmë që ky ligj ka shtrirje shumë më të gjerë. Është një ligj që mbron, te paktën në të njëjtën masë gratë, minoritetet etnike, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe njerëzit që banojnë në zonat rurale.

Ndoshta një arsye përse ky ligj nuk njihet aq sa duhet, është se nuk ka ende një komisioner për diskriminimin.

Shpresoj që të caktohet dikush sa më shpejt të jetë e mundur.

Prezenca e OSBE-së mbetet e gatshme për të mbështetur një komisioner të tillë me ndihmesë në hartimin e legjislacionit dytësor.

Së fundi, për sa i takon sistemit të gjykatave, integriteti i procesit gjyqësor vazhdon të mbetet një sfidë.

Kohët e fundit ka pasur shumë debate në lidhje me postet vakante në Gjykatën Kushtetuese, dhe që do të rezultojë në zëvendësimin e dy të tretave të Gjykatës.

Do t'u kujtoja të gjithëve rëndësinë e kujdesit që duhet treguar në përzgjedhjen e anëtarëve të rinj në këtë organ.

Procesi duhet të jetë transparent.

Gjyqtarët duhet të përzgjidhen bazuar në njohuritë ligjore që ata kanë, në aftësitë e tyre për arsyetim ligjor, dhe mbi të gjitha, për integritetin e tyre.

Të njëjtat kritere duhet të përdoren në marrjen e të gjitha vendimeve për ngritjen në detyrë të personave në sistemin gjyqësor – gjithashtu edhe për sa i takon Gjykatës së Lartë dhe Gjykatave të Apelit, në mënyrë që të ketë përmirësim të dukshëm në cilësinë e drejtësisë që ofrohet.

Zonja dhe zotërinj, Prezenca në Shqipëri mbetet e gatshme që të ofrojë ndihmesë të mëtejshme për të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit dhe sektorit ligjor në Shqipëri.

Për ta mbyllur, u uroj të gjithë personave të pranishëm sot, gjithë të mirat dhe suksese të mëtejshme gjatë vitit të ardhshëm.

Ju faleminderit shumë!

E.o.T.

CHECK AGAINST DELIVERY